

III REZULTATET

A) PUBLIKIMI I TEKSTEVE

Në kuadër të këtij projekti janë publikuar këto tekste:

1. Strukturë për zhvillimin e mendimit kritik gjatë leximit e shkrimit, Udhëzues 1, KEC & ARA, Prishtinë, 2001.
2. Zhvillimi kognitiv dhe social i fëmijës, Udhëzues 2, KEC & ARA, Prishtinë, 2001.
3. Leximi, shkrimi dhe diskutimi në çdo lëndë, Udhëzues 3, KEC & ARA, Prishtinë, 2001.
4. Teknika të tjera për zhvillimin e të menduarit kritik, Udhëzues 4, KEC & ARA, Prishtinë, 2001.
5. Të nxënët në bashkëpunim, Udhëzues 5, KEC & ARA, Prishtinë, 2001.
6. Planifikimi i mësimit dhe vlerësimi, Udhëzues 6, KEC & ARA, Prishtinë, 2001.
7. Seminari për të shkruarit "nga të vetëshprehurit tek argumentet e shkruara", Udhëzues 7, KEC & ARA, Prishtinë, 2001.
8. Krijimi i lexuesve mendimtarë, Udhëzues 8, KEC & ARA, Prishtinë, 2001.
9. Modele për mësimdhënie të suksesshme, "Edualba", Tiranë, 2001.
10. Puna me të rriturit, KEC & ARA, Tiranë 2001



Është botuar, gjithashtu, edhe Plani Ditor (për projektin Programi i arsimit cilësor), por që ju shpërndahet edhe pjesëmarrësve në programin tonë. Vlen të theksohet se ky është akt suplementar në projekt sepse si i tillë nuk ka qenë i paraparë, madje është realizuar jashtë buxhetit të paraparë.

B) OPINIONET E ARSIMTARËVE, NXËNËSVE DHE PRINDËRVE

Për të hetuar rezultatet e projektit: **Të nxënët ndërveprues**, kemi marrë opinionet e arsimtarëve, nxënësve dhe prindërve. Për studim rasti kemi zgjedhur tri shkolla pilot nga gjithsej dhjetë sa i kemi të përfshira në projekt dhe ato:

- Shkolla fillore "Nezim Berati" në Dragash (ka të përfshirë 4 arsimtarë të minoritetit boshnjak)- 22. janar 2002;
- Shkolla fillore "Vaso P. Shkodrani" në Pejë, 23 janar 2002 dhe
- Shkolla fillore "Shaban Jashari" në Skënderaj, 23 janar 2002.

Nga arsimtarët, nxënësit dhe prindërit kemi kërkuar që të shprehen për përshtypjet, efektet, përvojat etj. si rezultat i katër seminareve të zhvilluara deri më tani. Ata kanë qenë tërësisht të lirë të shprehen sepse ne nuk u kemi pararashtuar pyetje të standardizuara të cilat në ndonjë mënyrë do të diktonin përgjigjet por thjesht janë shprehur në atë mënyrë se si ata e ndiejnë atë.

B. 1. Opinionet e arsimtarëve

Në vazhdim po japim disa pjesë nga shënimet e arsimtarëve, të cilat, të plota i japim në aneks - origjinal në dorëshkrim:

Nadil Dauti,
mësues klasorë në
shkollën fillore
"N. Berati"
të Dragashit




"...Në fillim të seminarit më është dukur se metodat klasike janë të pazëvendësueshme. Por pas dy ditëve seminar kuptova se të nxënët ndërveprues... të gjitha ato teknika që i mësuam, në mënyrën më të përsosur i ndërrojnë metodat klasike.

Gjatë orës të gjithë nxënësit janë aktivë, shumë të lirë dhe pjesëmarrës të barabartë në mësim.

Pas përdorimit të këtyre metodave dhe teknikave edhe sukcesi në klasë dukshëm u përmirësua dhe edhe ata dy nxënës të dobët iu bashkangjiten atyre të mirëve."

Ismail Isaki,
arsimtar klasorë në
shkollën fillore
"N. Berati"
të Dragashit
(i minoritetit
boshnjak)




"Kur në gusht të vitit 2001 jam njoftuar se duhet të marrë pjesë në seminarin katër ditor, kam konsideruar se edhe ky seminar do të jetë si shumë seminare tjera të mëparshme, ku do të bisedohet për disa çështje profesionale. Sot kur mendoj pas 12 ditëve të seminarit vërej se jam mashtruar sepse nuk është ajo e njëjta që kam menduar. Diçka e fuqishme ka ndodhur në kokën time...Nuk konsideroj më se detyrë e imja si arsimtar është të mbush kokën e nxënësit vetëm me informacione të mërzitshme. Metodrat e reja të cilat i kam njohur në seminare kanë ndryshuar çasjen dhe raportin kundrejt nxënësve. Nuk jam më burim kryesor i njohurive të nxënësve.Tani nxënësit deri te njohuritë arrijnë vetëm nëpërmjet ndihmës së nxënësve tjerë dhe teksteve.

Nxënësit janë mjaft aktiv dhe të interesuar për këtë mënyrë të punës sepse kanë liri të plotë të mendimit dhe të kuptimit... edhe puna në grupe në klasë krijon gjithsesi atmosferë tjetër. Me këto metoda nxitet të menduarit kritik dhe të kuptuarit.

Sigurisht se në punë ka edhe probleme. Si problem i parë është koha. Është vështirë që këto metoda të përmbledhen në orën mësimore e cila zgjat 40 ose 45 minuta. Pastaj programet e punës...tekstet joadekuate... Me gjithë këto kam mendim shumë të lartë për të nxënësit ndërveprues. Kjo për mua është të nxënësit e ardhmërisë."


Lajko Shejvat,
arsimtar
në shkollën fillore
"N. Berati"
të Dragashit
(i minoritetit boshnjak)



"...Kjo mënyrë e punës ka anët pozitive dhe negative.Anë pozitive janë se në procesin e mësimin tani në mënyrë aktive përfshihen të gjithë nxënësit dhe se ekziston bashkëpunim i ndërsjellë në kuadër të tërë grupit të klasës. Ata nuk kanë më komplekse se do të gabojnë apo jo. Anë negative të saj janë se tekstet nuk janë të konceptuara për këtë mënyrë të punës dhe se nuk kemi kabinete të përshtatshme dhe mjete mësimore.

Është mendim i imi se duhet të gjithë kolegët të përfshihen në këtë mënyrë të punës në mënyrë që nxënësit të kenë një kontinuitet të punës..."

Ardiana Hyseni,
arsimtare e Matematikës
në shkollën fillore
"V.P. Shkodrani"
të Pejës




"...Anët pozitive të këtyre metodave dhe të formave të të nxënësit ndërveprues janë të shumta si psh.:

1. Nxënësit shprehin dëshirë të madhe të punojnë në grupe sepse ndihen të lirë, dëshirojnë të bashkëpunojnë dhe shprehin idetë pa u hamendur;
2. Të gjithë nxënësit janë aktivë, së paku angazhohen në dhënien e ideve dhe mendimeve;


3. Para se t'i vlerësojmë ne ata , ata vlerësojnë njëri tjetrin;
4. Korrelacioni me kolegë është në nivel;
5. Prindërit shprehin kënaqësi dhe pajtim me këtë punë-me metoda të reja;
6. Por, ora mësimore është e shkurtër prej 45 minutash."

Arjeta Jakupi,
arsimtare klasore
në shkollën fillore
"V.P. Shkodrani"
të Pejës



"...Seminari ka sukses të madh dhe është mjaft i qëlluar sidomos për ciklin e ulët. Raportet nxënës – arsimtar janë shumë liberale..."

Visare Gashi,
arsimtare klasore
në shkollën fillore
"V.P. Shkodrani"
të Pejës



"...Trajnimet tona kanë pasr sukses të madh nga që format tona të dikurshme stereotipe të punës janë të tejkaluara...Konsideroj se këto që po bëjmë tani janë vetëm hapat e parë drejt avancimit të procesit mësimor më të qëndrueshëm dhe më përmbajtësor....Nxënësit punojnë në grupe kurse mendimi i tyre respektohet dhe nuk u "zihet në fyt".

Naser Gega,
arsimtar
në shkollën fillore
"V.P. Shkodrani"
të Pejës



"Që nga fillimi i punës me këto metoda (shtator 2001) në shkollën tonë, vërehet një frymë e re e punës. Kam përshtypjen se kemi filluar punën nga e para. Asnjëherë më parë nuk ka ekzistuar një bashkëpunim mes mësimdhënësve si tani. Procesin mësimor po e pasurojmë në vazhdimësi falë teknikave të reja që po i përvetësojmë nga ligjërueset të cilat janë të shkëlqyera...Raportet mësimdhënës-nxënës kanë ardhur në nivelin më të kënaqshëm. Janë më këmbëngulës në

përvetësimin e njohurive të reja. Vetë zhvillimi i orës mësimore është më liberal...Prindërit kanë vërejtur ndryshim dhe shprehin respekt. Për fëmijë e tyre shkolla është kënaqësi e jo obligim."

Besim Perjuci,
arsimtar i gj. dhe l.
Shqipe
në skollën fillore
"V.P. Shkodrani"
të Pejës




"...Metodologjia e re e punës ka ndikuar pozitivisht dhe është pranuar shumë mirë nga vetë nxënësit... ata janë mjaft të kënaqur me aplikimin e teknikave të reja që janë mjaft tërheqëse për ta. Shumë më lehtë kuptojnë dhe shumë më lirshëm shprehin. Vlerësimi i nxënësve është më objektiv, ata e ndiejnë, e shohin dhe vetëvlerësojnë.

Aferdita Kastrati,
arsimtare
në shkollën fillore
"V.P. Shkodrani"
të Pejës




"...Duke i zbatuar këto teknika të reja të të nxënimit ndërveprues, punën kryesore e bëjnë vetë nxënësit...nxënësi me anë të aktiviteteve, lojrave, punës në grupe më shumë e zotëron lëndën..."

Myhedin Gjickolli,
drejtor
i shkollën fillore
"V.P. Shkodrani"
të Pejës



"Seminaret kanë pasur efekt pozitiv në mësim-sukses të nxënësve etj. Nxënësit më me lehtësi kuptojnë mësimet..., duke punuar së bashku ata shprehin mendimin e lirë të tyre, nuk lodhen. Dija e tyre vlerësohet realisht. Suksesi i nxënësve në këtë gjysmëvjetor ka qenë dukshëm më i lartë. Në raportin e Drejtoratit të arsimit në Pejë, suksesi i nxënësve të shkollë sonë renditet në vendin e katërt çka nuk ka qenë më parë. Më duket se nuk ka vend për fjalë të tjera."

Musa Dërguti,
drejtor
i shkollën fillore
"Shaban Jashari" të
Skenderajt



"...Çdo respekt për ligjëruesit dhe të gjithë atyre që kanë ndihmuar dhe kontribuar në çfarëdo forme për realizimin e këtij projekti. Unë personalisht dhe mësimdhënësit që janë duke ndjekur (por edhe të tjerë) me të cilët kam biseduar: prindër, nxënës etj. i përkrahin këto ndryshime pozitive të të nxënësve.

Është me rëndësi të theksohet se arsimtarët që përdorin këto teknika kanë më shumë sukses te nxënësve. Nxënësve shumë më lehtë i përvetësojnë, realizojnë dhe studiojnë të gjitha përmbajtjet që i ofrohen gjatë orës mësimore. Nxënësi është më i lirë, më tolerant ndaj shokëve, respekton mendimet e të tjerëve, bashkëpunon, shpreh mendimin e lirë, është komunikues, aktiv. Kjo tregon se këto reforma janë të mirëseardhura për shkollën tonë por edhe për shkollën shqipe në përgjithësi.


Në kuadër të kësaj shkolla jonë po kalon nga një shkollë tradicionale në një shkollë bashkëkohore."

Luljeta Deliu,
mësuese
në shkollën fillore
"Shaban Jashari"
të Skënderajt

"...Ky program (Të nxënësve ndërveprues, v.j.) ka shumë përparësi:


- Bashkëpunimi nxënës-arsimtar,
- Komunikimi i ndërsjellë nxënës-nxënës,
- Forma e punës në grupe,
- Shprehja e mendimit të lirë,
- Lehtësia e të nxënësve,
- Pjesëmarrja aktive,
- Interesimi i nxënësve,
- Vetëbesimi i nxënësve,
- Ndryshimet në të menduarit etj."

Mihane Mangjoli,
mësuese
në shkollën fillore
"Shaban Jashari"
të Skënderajt




"...Me shumë kënaqësi kam filluar t'i zbatoj disa prej teknikave. Nxënësit në fillim kanë qenë të hutuar dhe ora ishte e mërzitshme, disiplina kishte rënë. Pas orës së tretë dukej kënaqësia e nxënësve, dëshira për të mësuar ishte e madhe....Mësimi është më i lehtë, nxënësi më i lirë, hulumtues dhe do të ketë më shumë vetëbesim. Bashkëpunimi nxit kureshtjen dhe interesimin për mësim madje edhe ata që janë pasivë."

Sherife Ajeti,
mësuese
në shkollën fillore
"Shaban Jashari"
të Skënderajt



"...Të punosh me këto teknika do të thotë se kemi hyrë në një kohë bashkëkohore të mësimi....Drejtperdrejt janë parë frytet e mësimeve..."

Raza Gashi,
mësuese
në shkollën fillore
"Shaban Jashari"
të Skënderajt



"Gjatë seminareve të cilat i kemi përcjellë deri më tani – të projektit "Të nxënësit ndërveprues", kemi vërejtur se ndryshimi është shumë i madh kundrejt metodave klasike, sepse angazhimi, interesimi është shumë i madh si te nxënësit ashtu edhe te mësuesit. Ky program ka shumë përparësi..."